



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
VLORE

Nr. 2157 Akti
Date Regj.24.12.2015

Nr . 169 Vendimi
Date 16.02.2016

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Sot me date 16.02.2016, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore e përbëre nga gjyqtari KEN DHIMA, asistuar nga sekretaria gjyqësore Kamila Petriti, shqyrtoi ne seance gjyqësore me dyer te hapura çështjen civile me Nr. 2157 Regj, date 24.12.2015 qe i përket:

PADITES:

"Tur Cobo"shpk përfaqësuar me autorizim nga Av. Enkes Hysendhima, ne mungese.

TE PADITUR:

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlore,ne mungese.
Drejtoria e Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Tatimeve Tirane,ne mungese.

PERSON I TRETE:

Zyra Vendore e Avokatit te Shtetot Vlore, ne mungese.

OBJEKTI:

Kundërshtimi i njoftim vlerësimi tatimor Nr. 14034 Prot date 07.11.2015 te Drejtorisë Rajonale te Tatimeve Fier.

Ndryshimi I vendimit Nr. 30991 Prot date 24.11.2015 te Drejtorisë se Apelimit Tatimor

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 9920 dt. 19.05.2009 "Për procedurat tatimore ne RSH" . Udhezimi i Ministrit te Financave Nr. 24,

Mosmarrëveshjeve Administrative”, rezulton se : “Paditë kundër veprimin administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet”. Pate e paditur ne këtë proces është Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlore.

Gjate gjykimit u provua fakti se paditesi "Tur Cobo" shpk eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K) e regjistruar ne Drejtorine Rajonale te Tatimeve Vlore me Nipt K66424202E me aktivitetet "Prodhim tregtim i artikujve zdrukthetarie,druri,dyer , import eksport,tregti me shumice e pakice te lendeve te para dhe aksesoreve te ndryshem per punime zdrukthetari, mobilieri, dyer etj.

Zyra Qendrore e shoqerise ndodhet ne Vlore dhe nje vend tjetër i ushtrimit te aktivitetit ndodhet ne Fier Lagjja "Liri ", Rruga " Jakov Xoxa" , Pallati i ri, prane Shtepise se te Moshuarve, prane Ures se Sheqit i cili kryen funksionin e Show Room-it.

Ne daten 07.09.2015, u ushtrua nje kontroll ne show room-in e mesiperme ne qytetin e Fierit per te cilin u mbajt Akti i Konstatimit me Nr. 0489555 , date 07.09.2015 sipas te cilit rezultoi se subjekti eshte i pa pajisur me kase fiskale dhe nuk ka te afishuar listen e cmimeve. Per arsye se subjekti rezultoi i papajisur me kase fiskale ne baze te nenit 122 pika 1 germa a te ligjit Nr. 9920 date 19.05.2008, "Per procedurat tatimore ne RSH"u vendos masa e denimit administrativ gjobe ne masen **50.000 (pesedhjete mije) leke**. Per arsye se subjekti nuk ka te afishuar listen e cmimeve, ne baze te nenit 130 te ligjit Nr. 9920 date 19.05.2008 u vendos masa e denimit me gjobe ne masen **65. 000 (gjashtedhjete e pese mije) leke**.

Duke mos qene dakord me detyrimet e mesiperme paditesi, bazuar ne nenin 109 te Ligjit Nr. 9920 date 19.05.2008, "Per procedurat tatimore ne RSH" , paraqiti ankim prane Drejtorise se Apelimt Tatimor Tirane i cili me vendimin Nr. 30991 date 24.11.2015 (komunikuar me dt 29.11.2015) la ne fuqi aktin administrativ te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Fier . Brenda afatit te parashikuar nga ligji, paditesi ju drejtua Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Vlore si organi kompetent per zgjidhjen e kesaj mosmarreveshje duke kerkuar konstatimin e pavlefshmerise absolute te ketij akti administrativ si dhe shfuqizimin e tij.

Gjate shqyrtimit gjyqesor nga ana e pales paditese, me ane te provave shkresore te paraqitura u provua fakti se akti administrativ "Njoftim vleresimi tatimor" eshte nje akt administrativ absolutisht i pavlefshem referuar nenit 116 te Kodit te Procedurave Administrative pasi eshte marre ne kundërshtim flagrant me procedurat tatimore te parashikuara si dhe i pambeshtetur ne rrethanat e faktit. Eshte e vertete qe subjekti "Tur Cobo" Sh.p.k zhvillon nje pjese te aktivitetit e tij ne adresen ne te cilen u ushtrua kontrolli nga ana e inspektoreve te administrates tatimore , por ky objekt nuk sherben si qender per tregtimin e produkteve te tij por si nje ekspozite ose e thene ndryshe si nje show room per reklamimin e produkteve

rrethanave konkrete . Nese ata do kishin mbajtur parasysh rrethanat e fakteve do te ishin bindur se cmimet ishin te afishuara (*te ngjitura neper dyer*) por jo per faktin se ato dyer po shiteshin aty por vetem per nje transparence per klientet e interesuar qe vizitojne show room. Ne cdo doreze te dyerve te instaluara ne show room eshte vendosur cmimi perkates dhe kjo gje u be e ditur nga punonjesja jone aty , por nuk u mor parasysh nga inspektoret.

Subjekti "Tur Cobo" Sh.p.k i shet produktet e tij ose ne magazinat e ndodhura ne Vlore, ose i dorezon neper subjektet e interesuar me ane te mjeteve te tipit kamion te cilet jane te pajisur me kase fiskale. Qe paditesi nuk tregeton mallra ne kete adrese ne Fier u vertetua nga vete fotografite e dyerve , qe u paraqiten si prove gjate gjykimit, nga te cilat verehet se ato jane te mberthyera ne mur, nga siperfaqja e objektit te marre me qira qe eshte aq e vogel sa mund te mbaje vetem dyert e instaluara aty brenda.

Gjithashtu, fakti qe, si Aktet e konstatimit ashtu edhe procesverbalet e gjobave perkatese jane perpiluar vetem nga dy inspektore, nderkohe qe vete formulari parashikon prezencen e tre inspektoreve, tregon se keto akte jane te pavlefshme pasi jane marre ne kundersizim me formen e parashikuar nga ligji.

Gjate gjykimit u provua me se miri se subjekti "Tur Cobo" Sh.p.k, ne ambientet e Show room te ndodhur ne Fier, nuk realizon qarkullim malli por vetem ekspozon mallin per klientet duke ju ngjitur dyerve edhe cmimet perkatese. Ne rastin se bleresi vendos te blejë mallin e ekspozuar , atehere subjekti leshon kuponin tatimor ne momentin e dorezimit te mallit ne adresen e bleresit me anen e kases fiskale te instaluar ne automjetin e subjektit ose ne rast se klienti vendos te perdor mjetin e tij per te transportuar dyert, atehere subjekti i leshon kupon tatimor nga kasa fiskale e instaluar ne ambientet ku perpunohen dyert. (*ne adresen kryesore te shoqerise, ne Vlore*)

Për sa me sipër gjykata vlerëson se kerkesepadia është e bazuar ne prova dhe ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

Për këto arsye

Gjykata bazuar ne Ligjin Nr. 9920 dt. 19.05.2009 "Per procedurat tatimore ne RSH" Udhezimi i Ministrit te Financave Nr. 24, dt. 02.09.2008, VKM Nr. 781, date 14.11.2007 "Per karakteristikat teknike e funksionale te pajisjeve fiskale, sistemit te integruar te kompjuterizuar per transferimet periodike, automatike, te deklarimeve financiare, sistemit te komunikimit, per proceduren e dokumentacionin per miratimin e tyre dhe per kriteret per pajisjen, me autorizim, te shoqerive te autorizuara per ofrimin e pajisjeve fiskale", Ligj Nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimit e

mosmarreveshjeve administrative" Nenet 324 e vijues te K. Pr. Civile; Kodi i Procedurave Administrative,

VENDOSI:

1. Pranimin e kerkesepadisë si te bazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Konstatimin si akt absolutisht te pavlefshem te aktit administrativ "Njoftim vlerësimi tatimor" Nr. 14034Prot, date 07.11.2015 te Drejtorisë Rajonale te Tatimeve Fier .
3. Anullimin e aktit administrativ gjobe ne masen 115.000(njeqind e pesembedhjete mije) leke te vendosur subjektit " Tur Cobo" Sh.p.k.
4. Konstatimin si akt absolutisht te pavlefshem te aktit administrativ Vendimi me Nr. 30991 Prot date 24.11.2015 te Drejtorisë se Apelitit Tatimor.
5. Ndaj ketij vendimi nuk nxirret urdher ekzekutimi.
6. Ky vendim eshte I ekzekutueshem prej Zyres se Permbarimit Gjyqesor menjehere.
7. Shpenzimet gjyqësore ne masen 32.000(tridhjete e dy mije) leke dhe ato te mbrojtjes ne masen 48.000 (dyzete e tete mije) leke ne ngarkim te palëve të paditura.
8. Ndaj ketij vendimi nuk nxirret urdher ekzekutimi.
9. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Shërbimi Përmbarimor menjehere.
10. Ky vendim eshte i formes se prere dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Vlore , sot ne dt. 16.02.2016.

**SEKRETARE
KAMILA PETRITI**



**GJYQATAR
KEN DHIMA**

